

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Komuna e Prishtinës*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-4660-2-1-1.**

Sa i përket tenderit për *(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI".SH.A

"RRUGA TAHIR ZAJMI NR.5 PRISTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS"
(Adresa)

PRISHTINË

(Vendi)

048623625

10000

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

VANESA DERVISHAJ ZPP

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

VANNESADERVISHAJ@GMAIL.COM

(Adresa elektronike)

22.08.2024

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

AK KUVENDI KOMUNAL I PRISHTINËS KA SHPALLUR TENDER ME DATËN ME DATËN 15.05.2024,

AKTIVITETI I PROKURIMIT NR: 616-24-4660-2-1-1.

Njoftimi për kontratë 15.05.2024.

Njoftimi për dhënie të kontratës 30.07.2024

Kërkesa për rishqyrtim e ushtruar nga "Pastrimi"sh.a me datën 05.08.2024.

Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim datë 12.08.2024.

Autoriteti Kontraktues: KK "Prishtinë" më datën 13.08.2024 ka nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik, njoftimi i nënshkrimit të kontratës është bërë me datë 16.08.2024.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Arsyeja për mos aplikim ka qenë fakti se ne si kompani Publike Komunale kemi "Kontratën në Shtëpi" me AK-në, si kontratë e përcaktuar dhe rregulluar sipas legjislacionit sekondar e cila është aktive dhe në zbatim e sipër që përfshin edhe natyrën e asaj që është tenderuar procedura tanimë e ankimuar nga ana jonë. Fakt tjetër është që lidhur me këtë procedurë ne jemi vu në dijeni vetëm atëher kur AK ka shpallur Njoftim

mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës e datës 30.07.2024, ku ne si palë e dëmtuar kemi drejtuar menjëherë ankesë tek AK.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, si ndërmarrje publike lokale ka ushtruar kërkesë për rishtqyrtim në Autoritetin Kontraktues KK."Prishtinë" me datën 05.08.2024.

Bazë për kërkesën e rishtqyrtimit është fakti se kemi kontratë valide me KK."Prishtinë" për shërbimet e njëjta të cilat ky autoriteti kontraktues tanimë ka nënshkruar kontratë, duke dyfishuar shërbimet dhe në të njëjtën kohë duke rrezikuar seriozisht të krijoj dëm të konsiderueshëm financiar për kompaninë publike Pastrimi

Kërkesa e Ndërmarrjes publike "Pastrimi"Sh.a për autoritetin Kontraktues KK."Prishtinë" është që të anulohet njoftimi për kontratë dhe njoftimi për dhënien e kontratës, aktiviteti i prokurimit me nr.616/24/4660-2-1-1, duke qenë se "Pastrimi"sh.a është duke i ekzekutuar të njëjtat shërbime në bazë të kontratës valide me KK"Prishtinë" të datës 29/02/2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi i Prokurimit;
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
Është shkelur Rregullorja e Prokurimit Publik Neni 61; Neni 21.par.8.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përshkrim lidhur me ecurinë, faktet dhe argumentet,

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURIANAVE "PASTRIMI" SH.A. KA KONTRATË VALIDE ME KOMUNËN E PRISHTINËS, QË NGA DATA 29.02.2024, E CILA ËSHTË ENDE NË VAZHDIM E SIPËR.

KONTRATA E NËNSHKRUAR NDËRMJET KOMUNËS SË PRISHTINËS DHE KOMPANISË REGJIONALE "PASTRIMI" SH.A I OBLIGON PALET T'I PËRMBAHEN KUSHTEVE DHE ZBATUESHMËRISË SË SAJ PËR NJË PERIUDHË 1 VJEÇARE, RESPEKTIVISHT DERI MË DATËN 31.12.2024, ME MUNDËSI VAZHDIMI.

LËNDA E KONTRATËS ËSHTË ofrimin e shërbimeve primare të menaxhimit dhe grumbllimit të mbeturinave në gjithë territorin e Komunës së Prishtinës e cila përfshinë edhe trajtimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme. Në nenit 1 të kësaj kontrate është përcaktuar "Objekti i Kontratës" përmes të cilës është përcaktuar qartë se KRM "Pastrimi" Sh.A. është përgjegjës për mbledhjen, largimin dhe deponimin e mbeturinave të amvisërisë, **vëllimore dhe inerte** në të gjithë territorin e Komunës së Prishtinës, përfshirë qytetin dhe fshatrat e saj.

KOMPANI A REGJIONALE PASTRIMI SH.A DERI MË TANI KA ZBATUAR NË TËRËSI DISPOZITAT E KONTRATËS DHE KA OFRUAR SHËRBIMET NË PËRPUTHJE TË PLOTË ME TERMAT E REFERENCËS SË KONTRATËS.

PROVË: KONTRATA E NËNSHKRUAR ME DATËN 29.02.2024 NDËRMJET "PASTRIMI" SH.A NË NJËRËN ANË, DHE KK. I PRISHTINËS NË ANËN TJETËR.

PAVARËSISHT SE KONTRATA ËSHTË NË VAZHDIM E SIPËR DHE DUKE U ZBATUAR NGA “PASTRIMI” SH.A, PËR TË NJËJTIN OBJEKT TË SHËRBIMEVE KK. PRISHTINË KA SHPALLUR NJOFTIM PËR KONTRATË ME DATËN 15.05.2024, DUKE SHPALLUR TENDER PËR SHËRBIMET QË “PASTRIMI” SH.A. AKTUALISHT ËSHTË DUKE I ZBATUAR NË PËRPUTHJE ME KONTRATËN EKZISTUESE VALIDE.

“PASTRIMI” SH.A ËSHTË I SHQETËSUAR SE SI KA MUNDËSI QË AUTORITETI KONTRATËS “KK. PRISHTINËS” TË HY NË RAPORT KONTRAKTUAL DERISA KA KONTRATË TË VLEFSHME ME NDËRMARRJEN PUBLIKE “PASTRIMI” SH.A, DUKE KONTRAKTUAR OPERATOR EKONOMIK PRIVAT, PËR SHËRBIME QË JANË DUKE U KRYER NGA NDËRMARRJA JONË PUBLIKE.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË FAKTIN SE KËTO SHËRBIME JANË NË KUADËR TË KONTRATËS TË NËNSHKRUAR NGA DY AUTORITETE PUBLIKE, SIÇ ËSHTË KK”PRISHTINËS” DHE NDËRMARRJA PUBLIKE KRM “PASTRIMI” SH.A, KONSIDEROJMË SE SHPALLJA E KËTIJ AKTIVITETI TË PROKURIMIT ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME PARIMET E KURSIMIT TË BUXHETIT PUBLIK SI DHE PARIMIT TË EKONOMICITETIT DHE EFIKASITETIT.

MADJE NË KËTË RAST BËHET FJALË PËR DUPLIFIKIM TË SHËRBIMEVE SI DHE DËMTIM TË KOMPANISË “PASTRIMI” SH. A, MARRË NË KONSIDERATË SE KOMPANIA PUBLIKE “PASTRIMI” KA BËRË PLAN OPERATIV TË POSAÇËM PËR TË ZBATUAR KËTO LLOJE TË SHËRBIMEVE DUKE NDARË BURIME E RESURSE TË PUNËTORËVE PËRSHTATSHMËRISHT ME KONTRATËN E NËNSHKRUAR ME KK.”PRISHTINË” ME DATËN 29.02.2024.

NDËRMARRJA GJITHASHTU DEKLARON SE KA AKTIVITET TË VLEFSHËM TË PROKURIMIT NË PROCES E SIPËR QË KANË REZULTUAR NGA PËRGJEGJËSITË E KONTRATËS QË ËSHTË NËNSHKRUAR PARAPRAKISHT ME KOMUNËN PËR TË NJËJTAT SHËRBIME.

PROVË: DOKUMENTACIONI I AKTIVITETIT TË LARGIMIT TË MBETURINAVE VËLLIMORE INERTE.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË FAKTIN SE KEMI PASUR KONTRATË ME KK. “PRISHTINË” KEMI TENTUAR TË KOMUNIKOJMË PËRMES TELEFONIT PËRSE PO SHPALLET TENDER PËR NJË AKTIVITET QË TANIMË ËSHTË DUKE U ZBATUAR ME KONTRATË PUBLIKE NDËRMJET KK. PRISHTINË DHE “PASTRIMI”, POR NUK KEMI MARRË ASNJË PËRGJIGJE. MEQENËSE NUK KEMI MARRË PËRGJIGJE SI AUTORITET PUBLIK, KRM “PASTRIMI”SH.A PASI KA VËRTETUAR FAKTET SE NË UEB FAQEN E - PROKURIMI TË KK”PRISHTINË” JANË SHPALLUR FITUES DY KOMPANI PRIVATE NË DY LLOTE PËR SHËRBIMET QË NE KEMI KONTRATË NË REALIZIM E SIPËR, KA ADRESUAR EDHE KËRKESË PËR

PROVË: UEB – FAQJA E – PROKURIMI KK”PRISHTINË”.

Shkeljet që AK ka bërë në procedurë:

Autoriteti Kontraktues KK.Prishtinë, ka shkelur kontratën ekzistuese me ndërmarrjen Publike Komunale "Pastrimi"sh.a

- **Nenit 1** i "Kontratës në Shtëpi" me numër 14-024/01-30928/24, të datës 29.02.2024 e cila përfshinë edhe trajtimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme i lidhur në mes Komunës së Prishtinës (AK) dhe Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi" SH.A. (ofrues i shërbimeve).

Komuna e Prishtinës, si marrës i shërbimeve dhe KRM "Pastrimi" Sh.A si dhënës i shërbimeve, kanë lidhur kontratën "Në Shtëpi" me numër 14-024/01-30928/24, të datës 29.02.2024 për ofrimin e shërbimeve primare të menaxhimit dhe grumbllimit të mbeturinave në gjithë territorin e Komunës së Prishtinës e cila përfshinë edhe trajtimin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme. Kjo kontratë është lidhur në bazë të nenit 9, paragrafi 4 dhe nenit 87, paragrafi 2, nënparagrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 04/L-092 si dhe legjislacionit sekondar të prokurimit publik interpretimi nr.1 "1. 22.11.2022 Duke marrë për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese, dhe kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik? Konform nenit 87, paragrafi 2, nënparagrafi 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i lartëcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (në mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo, është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjnë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "në shtëpi). Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tua, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP."

Në nenin 1 të kësaj kontratës "Në shtëpi" është përcaktuar "Objekti i Kontratës" përmes të cilës është përcaktuar qartë se KRM "Pastrimi" Sh.A. është përgjegjës për mbledhjen, largimin dhe deponimin e mbeturinave të amvisërisë, **vëllimore dhe inerte** në të gjithë territorin e Komunës së Prishtinës, përfshirë qytetin dhe fshatrat e saj. Pavarësisht që kontrata në fjalë e cila është në zbatim e tutje dhe aktive, Komuna e Prishtinës pa asnjë paralajmërim paraprak dhe pa ndryshuar kontratën në fjalë tanimë valide ka shpallur aktivitetin e prokurimit: 616-24-4660-2-1-1 (2 lloje) ku bëhet fjalë për të njëjtën aktivitet e cila përfshihen në kontratën në shtëpi. Me këtë veprim Komuna e Prishtinës si autoritet kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këtë kontratë duke shkelur kështu nenin më bazik të kontratës.

- **Neni 6, 7 dhe 9 i LPP-së, ndërlidhur me nenin 1 të LLP-së,** ku bëhet fjalë për çmimin më të lartë të Rekomanduar për kontratë që ndikon direkt në ekonomikitet dhe efikasitet të AK, barazia në trajtim/jodiskriminimi si dhe duke mos marrë masat e nevojshme për të siguruar që lidhur me shërbimin e kërkuar nuk ofrohet edhe nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Në kontratën e lidhur mes Komunës së Prishtinës dhe KRM "Pastrimi" Sh.a, ndër të tjerash ka të përcaktuar edhe çmimin për shërbimin e trajtimit të mbeturiave vëllimore, inerte dhe ndërtimore, çmim i cili është tre (3) Euro për m3 (gjeni të bashkëngjitur shtojcën e çmimit si pjesë përbërëse e kontratës). Ndërkohë, oferta e rekomanduar për këtë aktivitet ka çmim më të lartë se sa ajo që është e kontraktuar me kontratën në shtëpi. Çmimet e kontraktuara nga Komuna e Prishtinës janë: për LLOT 1 është 4.70 EUR, ndërsa për LLOT 2 është 4.50 EUR. Me këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili përcakton që autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë përdorimin më ekonomik dhe efikas të fondeve publike, ku më konkretisht citohet që: *"Te gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të perdoren në mënyrë ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit."* Rrjedhimisht me këtë dispozitë Komuna e Prishtinës si AK duke qenë në dijeni që ekziston kontrata në shtëpi e cila është valide dhe në zbatim e sipër ka vepruar tutje në këtë procedurë duke për zgjedh çmim më të lartë për 1.70 EUR në LLOT 1 dhe çmim më të lartë për 1.50 EUR në LLOT 2, e që i bie përveç që ka sjellë diskrimin në trajtimin e KRM "Pastrimi" si ndërmarrje publike tani të kontraktuar me kontratë, gjithashtu ka për zgjedhur operator që do të paguhet më shumë se sa ajo çka kontrata ekzistuese ofron për të njëjtin shërbim (me çmim 3 EUR). Me këto veprime autoriteti kontraktues ka vepruar edhe në kundërshtim me neni 7 të LPP-së duke bërë trajtim jo të barabart dhe diskriminues, ku ndër të tjerash në paragrafin 1 dhe 4 citohet që: *"Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente... Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik"*.

Tutje me këto veprime Komuna e Prishtinës si AK ka rrezikon mirëqenien e ndërmarrjes publike KRM "Pastrimi" Sh.A, e cila është ndërmarrje publike lokale me aksionar kryesor vetë Komunën së Prishtinës me pronësi të aksioneve me 77.7 % të aksioneve. Kjo për faktin se e njëjta duke rekomanduar fituesit dhe publikimit të Njoftimit për Kontratë të këtij aktiviteti vepruar në kundërshtim me neni 9, paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton që autoritetet kontraktuese të marrin masa të arsyeshme për të siguruar që lëndët e nevojshme të jenë në dispozicion nga autoriteti publik përkatës, ku konkretisht citohet që: *"Nese autoriteti kontraktues eshte autoritet publik, autoriteti i tille publik duhet te marre masa te arsyeshme per t'u siguruar se lendet qe i permbushin keto nevoja nuk jane ne dispozicion nga ndorye autoritet tjeter publik."* e që rrjedhimisht në këtë rast AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret e aq më pak duke qenë në dijeni që ekziston kontrata valide me KRM "Pastrimi" SH.A. si autoritet publik ka vepruar duke proceduar në këtë aktivitet.

Në kuptim të këtyre dispozitave vërehet qartë që Komuna e Prishtinës si AK ka anashkaluar përcaktimet ligjore në fjalë e në mbi të gjitha ka vepruar në kundërshtim të plot edhe me vetë qëllimin dhe fushveprimin e LPP-së i cili përcakton qartë në nenin 1 se: *"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do*

të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla... Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji... Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji”.

PROVË: Ankesi i çmimore sipas kontratës në shtëpi

PROVË: Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për aktivitetin 616-24-4660-2-1-1

- Neni 6 i “Kontratës në Shtëpi” me numër 14-024/01-30928/24, të datës 29.02.2024 i cili rrezikon seriozisht dëmtim financiar në qëndrueshmërinë e KRM “Pastrimi” SH.A si ndërmarrje publike regjionale me aksionar komunal.

Me aktivitetin e prokurimit në fjalë, Komuna e Prishtinës është duke rrezikuar seriozisht mirëqënien dhe qëndrueshmërinë financiare të KRM “Pastrimi” Sh.A. kjo për faktin se “Kontrata në Shtëpi” me numër 14-024/01-30928/24, të datës 29.02.2024 është në fuqi pa asnjë ndryshim dhe kontratë e cila në përmbajtje të saj parasheh qartë obligime për KRM “Pastrimi” si ofrues i shërbimeve të kontraktuara e të cilat kanë të bëjnë me investime kapitale, administrative dhe operative vetëm për Komunën e Prishtinës (Njësinë e Prishtinës). Më konkretisht në nenin 6 të kontratës në fjalë, ndër të tjerash në paragrafin 1, citohet që: “KRM Pastrimi obligohet që të gjitha të hyrat që gjenerohen nga të gjitha shërbimet e ofruara përmes kësaj kontrate ti investoj në ngritjen e cilësisë së shërbimit brenda njësisë së KRM Pastrimit në Prishtinë duke përfshirë investim në makineri, pajisje, staf profesional, të cilat shërbejnë vetëm për njësinë e Prishtinës”. Derisa në paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohen obligimet që: “KRM Pastrimi Obligohet të Siguroj stafin, Makineritë dhe pajisjet për ofrimin ndaras të shërbimit të grumbullimit të secilit lloj të mbeturinave, të parapara me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave”. Në kuptim të këtyre obligimeve ne si kompani kemi bërë veprime konkrete të cilat kanë rrjedh obligime financiare sikurse që është vepruar në shtimi i stafit shtesë në Njësinë e Higjienës si njësi e veçantë për largimin e mbeturinave vëllimore dhe inerte, aktiviteti i prokurimit publik për largimin shtesë të sasive të grumbullimit të mbeturinave nga pjesë të ndryshme të Komunës së Prishtinës, aktivitetin e prokurimit publik për marrjen me qera të kamionëve për bartje të mbeturinave, aktivitetin e prokurimit për rregullimin e kamionetave, etj. Për të gjitha këto veprime në vazhdimësi Komuna e Prishtinës duke pas parasysh që është edhe aksionar kryesor në KRM Pastrimi ka qenë e informuar për këto veprime, ku edhe përkundër këtij fakti përsëri ka vepruar në procedim të këtij aktiviteti.

PROVË: Aktiviteti i prokurimit për eliminimin dhe bartjen e mbeturinave vëllimore dhe inerte

PROVË: Aktiviteti i prokurimit për rregullimin e kamionetave

PROVË: Aktiviteti i prokurimit për marrjen me qera të kamionëve për bartje të mbeturinave

PROVË: Aktiviteti i prokurimit për furnizim me fatura

PROVË: Konkurse të hapura për punëtorë fizik në mënyrë që të rritet kapaciteti i punës.

- Neni 108/A i LPP-së dhe neni 61, pika 1, 3 e Rregullores për Prokurim Publik, duke bërë Shkelje të procedurave për pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim.

Bazuar në nenin 61, pika 1 e Rregullores për Prokurim Publik lidhur me nenin 108/A i LPP-së, është përcaktuar Pezullimi i aktivitetit të prokurimit, ku konkretisht citohet që: “Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe në këtë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftoj me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjale. a. Kurdo që pezullimi i përmendur ndërlidhet me vendimin e AK për dhenie të kontratës, pezullimi i tillë nuk do të përfundojë para skadimit të një periudhe prej të paktën 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të vendimit të AK”. Tutje lidhur me këtë, gjithashtu në nenin 61, paragrafi 3 i Rregullores në fjalë përcakton që: “Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë”. Bazuar në kuptim të kësaj dispozite, fillimisht AK nuk ka shpallur vendim për pezullim dhe nuk ka njoftuar palët e interesuara për një gjë të tillë gjë për të cilën ka qenë i obliguar ta bëjë. Përkundrazi, ka shpallur vendimin për dhënien e kontratës pa respektuar fare as periudhën e pezullimit prej 10 ditësh kalendarike siç përcaktohet. Madje edhe vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim e ka nxjerrë me vonesë se sa që është përcaktuar në dispozitën e lartë cekur dhe se nga AK nuk kemi marrë asnjë përgjigje se pse ka ardhë deri tek kjo vonesë. Këtë e mbështesim në faktin në atë se me datë 30.07.2024 është shpallur njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, derisa KRM Pastrimi duke vlerësuar që është palë e dëmtuar në këtë procedurë më datë 05.08.2024 ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim tek AK, derisa Vendimi i AK lidhur me kërkesë nuk është pranuar deri më datë 12.08.2024 për çka të cilën nuk është dhënë madje as edhe një informatë se pse ka ardhë deri tek vonesa.

PROVË: Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues

PROVË: Kërkesa për rishqyrtim e datës 05.08.2024

PROVË: Vendimi i AK i datës 12.08.2024

Komuna e Prishtinës në rastin konkret gjithashtu ka vepruar në kundërshtim të plotë edhe me neni 21, par. 8 të Rregullores së Prokurimit Publik, sepse ka bërë nënshkrimin e kontratës me operatorët privat më datë 13.08.2024 pa kaluar afati ligjor për ankesa në

Organin Shqyrtues të Prokurimit sipas asaj që përcaktohet afati prej 10 ditësh edhe në vet vendimin e nxjerrë nga ta si AK.

PROVË: *Vendimi i AK për refuzimin e kërkesës së KRM “Pastrimi” Sh.A.*

PROVË: *NJOFTIMI PËR DHËNIEN E KONTRATËS i datës 12.08.2024*

PROVË: *NJOFTIMI PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATËS i datës 16.08.2024*

Është i paqëndrueshëm refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Komuna e Prishtinës si AK kur referohet që KRM “Pastrimi” Sh.A. nuk është palë në procedurë, sepse bazuar në të gjitha të lartëcekurat dhe për ato të tjera që janë të përcaktuara edhe në Ligjin për Prokurimin Publik dhe Legjislacionin sekondar e për të cilat ne si palë ankuese rezervohemi që për çështje të tjera të paraqesim edhe në seancë pranë panelit.

Madje, vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim nga AK është edhe i paqartë sa i përket përmbajtjes duke qenë se në pikën 2 të vendimit, AK vendos të vërtetohet njoftimi mbi vendimin e datës 31.07.2024 për **ANULIM “II. VERTETOHET njoftimi mbi vendimin i datës 31.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi”**, përderisa në njoftimin mbi vendimin e Autoritetit kontraktues të datës 31.07.2024 përcaktohet rezultati i AK për shpërbllim me kontratë për dy Lote.

Andaj nga të gjitha të lartë cekurat:

Propozojmë dhe kërkojmë, që Organi Shqyrtues i Prokurimit të anulojë njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin në fjalë, të shpallë të pavlefshme kontratën e nënshkruar ndërmjet Autoritetit Kontraktues KK.Prishtinë dhe Operatorëve ekonomik privat, si dhe ta detyrojë KK “Prishtinë” ta zbatojë kontratën valide ekzistuese ndërmjet saj, dhe Ndërmarrjes Publike Komonale “Pastrimi” sh.a.

Këtë duke marrë në konsideratë një vendim sa më efikas me emergjencë, për faktin se Ndërmarrjes Publike Komonale “Pastrimi” sh.a mund t’i shkaktohen dëme të pariparueshme, si rezultat i veprimeve të papërgjegjshme të Autoritetit Kontraktues KK”Prishtinë”.

Lidhur me natyrë të njejtë OSHP në të kaluarën ka nxjerrë edhe vendime:

Vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së për pretendimin e njejtë ankimor të shqyrtuar në të kaluarën (Vendimi nr. 373/20 i datës 11.06.2020, vendimi nr.48/20 i datës 11.03.2020, vendimi nr. 409/19 i datës 04.09.2019, vendimi nr. 338/19 i datës 16.08.2019 etj).

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale konsistojnë në vlerën e kompensimit kontraktual të kontraktuar ndërmjet Ndërmarrjes Publike Komonale “Pastrimi” sh.a dhe KK. “Prishtinë” është 72,000.00 Euro, si dhe dëmet investuese nga obligimet që kanë buruar nga e njëjta kontratë ndërmjet palëve që kapin vlerën e përafërt 218,511.00 Euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraparak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



pen: *[Signature]* *[Signature]*

Neni 1

Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është mbledhja, largimi dhe deponimi i mbeturinave të amvisërisë, vëllimore dhe inerte në tërë territorin e Komunës së Prishtinës si në qytet ashtu edhe në fshatra e cila do të bëhet sipas orarit si dhe sipas tarifave të cilat do të jenë pjesë të kontratës së nënshkruar me KRM "Pastrimi".

Neni 2

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Kontrate është që:

- 1.1. Të përkufizohen shërbimet që "Pastrimi" ia ofron komunës dhe standardet e kërkuara për mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.
- 1.2. "Pastrimi" dhe Komuna t'i kryejnë obligimet të specifikuara në rregullore dhe Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave.
- 1.3. Të përshkruhen kërkesat për menaxhimin cilësor të shërbimeve duke përfshirë specifikacionet e shërbimit, monitorimin e performancës dhe raportimin.

Neni 3

Çmimi

1. Çmimi për shërbimet e ofruara për palët e treta (bizneset, institucionet, si dhe personat fizik apo juridik që kërkojnë shërbim të veçantë të grumbullimit të mbeturinave nga ndërtim/demolimi, të vëllimshme dhe mbeturinave të kompostueshme) bazohet në Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave të aprovuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, derisa çmimi për shërbimet mujore të ofruara ndaj amvisërive bazohet në analizën e kostos për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave, të realizuar nga Komuna e Prishtinës, e cila është përcaktuar në shtojcën B.
2. Llogaritja do të bëhet për 72.000.00 njësi banimi të regjistruara aktualisht në data bazën e klientëve.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 2, numri i klientëve mund të ndryshoj në funksion të regjistrimit të klientëve të rinj, largimit nga lista të klientëve apo pasivizimit të përkohshëm të tyre, në përputhje me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave. Këto ndryshime dhe ndryshimet e tjera eventuale, të cilat burojnë edhe nga pikat e tjera të kësaj kontrate, do të evidentohen dhe gjithnjë në muajin pasues do të bëhet korrektimi i situacionit të pagesës.

Neni 4

Vlera e Kontratës dhe Kohëzgjatja

1. Vlera totale indikative e kësaj Kontrate është në shumën prej 2,549,167.00 €, ku këto mjete janë të parapara në kodin buxhetor 1.2.4.10.

2. Afati kohor i kontratës vlen për periudhën nga data 01 janar 2024 deri më datën 31 dhjetor 2024.
3. Afati kohor i kontratës nga paragrafi 2 i këtij neni mund të vazhdohet edhe për të njëjtën periudhë nën të njëjtat kushte, në rast se asnjëra nga palët kontraktuese nuk e konteston një gjë të tillë 30 ditë para skadimit të afatit primar.

Neni 5 **Përgjegjësitë e Komunës**

1. T'i caktojë, në bashkërendim me KRM "Pastrimi", lokacionet për vendosjen e kontejnerëve (sipas llojit) në vendbanime të ndryshme dhe në afërsi të arsyeshme me subjektet të cilave ju ofron shërbim. Poashtu komuna vendos për mënyrën dhe llojin e infrastrukturës së pikave të grumbullimit të mbeturinave për kontejnerët që do ti vendos.
2. Komuna do t'i kontrollojë, përmes Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit dhe të përpilojë raporte për mbikëqyrjen, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet që janë marrë, përkatësisht urdhëruar. Një kopje e raportit duhet t'i dorëzohet "Pastrimi" -të. Inspektori mbanë shënime për inspektimet që bëhen sipas procedurës që është përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe për procedurat e ndëshkimit bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr 14/2015 për ndëshkimet me gjoba mandatore.
3. Komuna është përgjegjëse që të gjithë personave fizik dhe juridik brenda territorit të saj, t'iu siguroj shërbim cilësor, të grumbullimit të mbeturinave. Rrjedhimisht, në rast se vërehet se shërbimi i ofruar nga KRM Pastrimi, nuk i plotëson standardet e kërkuara obligohet që të kontraktoj edhe kompani të tjera për kohë të caktuar për të siguruar respektim të plotë të rregullores dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kostot shtesë për ofrimin e këtyre shërbimeve do t'i zbatohen KRM Pastrimit.
4. Komuna mund ta testojë rregullisht kënaqësinë e konsumatorëve, me shërbimet e ofruara duke përcaktuar procedura adekuate dhe duke e nxjerrë një raport të shkurtër për nivelin e kënaqjes së konsumatorëve.
5. Të ofrojë qasje në pikat e grumbullimit të mbeturinave për kompaninë pastrimi.

Neni 6 **Përgjegjësitë e Pastrimit**

1. KRM Pastrimi obligohet që të gjitha të hyrat që gjenerohen nga të gjitha shërbimet e ofruara përmes kësaj kontrate ti investoj në ngritjen e cilësisë së shërbimit brenda njësisë së KRM Pastrimit në Prishtinë duke përfshirë investim në makineri, pajisje, staf profesional, të cilat shërbejnë vetëm për njësinë e Prishtinës.
2. T'i kryejë shërbimet në përputhje me këtë Kontratë me tërë shkathtësinë dhe kujdesin e duhur.
3. KRM Pastrimi obligohet që të siguroj stafin, makineritë dhe pajisjet për ofrimin ndaras,

të shërbimit të grumbullimit të secilit lloj të mbeturinave, të parapara me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave.

4. KRM Pastrimi mbanë të drejtën të gjeneroj faturë për secilin person fizik apo juridik që kërkon shërbim të veçantë të grumbullimit të mbeturinave, mirëpo njëkohësisht obligohet që të ofroj shërbim cilësor, në të kundërtën komuna e Prishtinës, si AK do të obligohet që të lidhë kontrata me operatorë të tjerë dhe kostot shtesë do t'i bartë KRM Pastrimi.
5. KRM Pastrimi pas nënshkrimit të kësaj kontrate obligohet që të siguroj kontejner adekuat për grumbullimin e mbeturinave nga ndërtim demolimi, të vëllimshme dhe të kompostueshme, në mënyrë që të sigurohet shërbim cilësor i menaxhimit të këtyre llojeve të mbeturinave.
6. Të mbledh, transportoj, trajtoj dhe deponoj të gjitha mbeturinat nga amvisëritë, mbeturinat e vëllimshme, te konstruktiv demolimit, mbeturinat animale, të gjeneruara nga bizneset që veprojnë në tërë territorin e komunës së Prishtinës.
7. KRM Pastrimi obligohet që në afat prej dy muajve të hartoj Plan Operativ të veçanta për grumbullim të secilit lloj të veçantë të mbeturinave të gjeneruara nga bizneset (mbeturinat nga mishtoret, mbeturinat e kompostueshme, gomat, vajrat, letrat (kartoni), hiri etj.) Gjithashtu, obligohet që të hartoj një Plan Operativ për grumbullim të mbeturinave të përziera, të gjeneruara nga bizneset. Duke marrë për bazë numrin e madh të bizneseve, të koncentruara në rrugë specifike, gjatë hartimit të Planit Operativ duhet të siguroj ofrim të shërbimit më të shpeshtë, sidomos në rrugët në vijim:
 - 7.1. Fehmi Agani
 - 7.2. UÇK
 - 7.3. Rruga B
 - 7.4. Nazim Gafurri
 - 7.5. Ibrahim Lutfiu
 - 7.6. Ilir Konushevi
 - 7.7. Dëshmorët e Kombit
 - 7.8. George Bushi
 - 7.9. Afrim Loxha
 - 7.10. Ali Hadri
 - 7.11. Muharrem Fejza
 - 7.12. Rruga C
8. Grumbullimi i mbeturinave nga bizneset do të bëhet i karakterit “*derë më derë*”, andaj edhe gjatë hartimit të Planeve Operative, duhet të sigurohet respektim strikt i orarit të përcaktuar.
9. Të sigurohet që të gjitha mbeturinat e mbledhura të dërgohen në vendet e caktuara në Deponinë Sanitare Regjionale Mirash, apo ndonjë deponi tjetër të caktuar nga Komuna.
10. Fillimi i operimit të nisë nga ora 06:00, në pikat ku ofrohet shërbimi me kontejnerë dhe të bëhet angazhimi i dy kamionëve shtesë për “pikat e nxehta” për zbrazje më të shpeshtë të kontejnerëve 24/7 (kontejnerëve të “Bahollit”, Tauk Bahqe, Ulpianë, Avalla, të Grandi, Qafa, Parku i Qytetit dhe pika të ngjashme në qytet).
11. Të bëhet angazhimi i një grupi të veçantë me katër kamioneta për largimin e deponive

ilegale të vogla në qytet 24/7 dhe ofrimin e shërbimeve për biznese-kafiteri, angazhimi i makinerisë së rëndë për largimin e deponive ilegale masive.

12. Ndryshimi i numrit të kontejnerëve dhe lokacionet e tyre nuk mund të bëhet pa aprovimin e organit mbikëqyrës së kontratës, respektivisht zyrtarëve përgjegjës brenda Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit.
13. Gjatë tërë ditës 24/7 të operohet me 4 kamioneta për largimin e mbeturinave nga bizneset, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat përreth kontejnerëve, ku 2 nga këto kamioneta dedikohen vetëm për zonën qendër dhe pjesën në afërsi të qendrës.
14. Të përgatitet dhe dorëzohet një PIO për aktivitetin e shërbimit, në të cilin tregohen operacionet rutinore për çdo vendbanim të shërbyer.
15. Të jetë përgjegjës për propozimin e orarit dhe të bëjë raportimin për progresin, parashikimin dhe kontrollimin e pavarur për ta arritur kryerjen e shpejtë dhe efikase të shërbimeve.
16. Është përgjegjës për largimin e mbeturinave nga deponitë masive/ilegale vetëm kur kjo kërkohet nga ana e Komunës.
17. Të bëjë largjen dhe dezinfektimin e pikave të grumbullimit sipas nevojës (minimum çdo dy javë) së paraqitur dhe për të njëjtën përgatit raport të veçantë, përmes së cilit e njofton edhe organin mbikëqyrës.
18. Të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha çështjeve financiare, duke përfshirë pagesat e pagave për staf, pagesën për deponimin e mbeturinave në Deponitë e përcaktuara nga KMDK apo ndonjë deponie tjetër të caktuar nga Komuna, të ardhurave dhe tatimet të tjera, kontributet e sigurimit kombëtar ose taksat e çfarëdo lloji që ndërlidhen me punësimin e ndonjë personi apo që burojnë nga ai punësim ose që ndërlidhen me funksionimin e kompanisë.
19. Ta krijojë dhe mirëmbajë një linjë telefonike pa pagesë dhe publikisht të dukshme brenda "Pastrimit", me një numër të telefonit dhe/ose adresë të postës elektronike në të cilën mund të kontaktohet në çdo kohë të ditës dhe të jetë në gjendje t'i pranojë ankesat dhe në sekretariatit e operativës/selisë së "Pastrimit". Ankesat do të evidentohen dhe të ju jepet përgjigje në to. Duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion për inspektim evidenca me shkrim për të gjitha ankesat që janë pranuar dhe veprimet që janë marrë në lidhje me ankesat e tilla.
20. Ta sigurojë mirëmbajtjen e rregullt dhe preventive të gjitha automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të saktësuara në mënyrë që të ngritët në maksimum produktiviteti dhe jetëgjatësia e pajisjeve për përdorim. Të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve që përdoren në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përshkruar në këtë kontratë.

Neni 7

Fushëveprimi i shërbimit

1. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, "Pastrimi" i mbledh, largon dhe transporton mbeturinat e amvisërisë, vëllimshme, kompostueshme dhe nga demolim konstrukcioni

që prodhohen brenda zonës së kufijve në tërë territorin e Komunës së Prishtinës.

2. "Pastrimi" e siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme (siç janë përkufizuar këtu) për ta ofruar një shërbim të kënaqshëm, që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në shtojcën A të kësaj kontrate.
3. "Pastrimi" i mbledh dhe transporton mbeturinat e amvisërisë, e vëllimshme dhe nga demolim konstruksioni nga të gjitha amvisëritë, subjektet afariste, institucionet publike si dhe hapësira tjera që gjenden në zonën e shërbyer në lokacionin e caktuar (siç tregohet nga Komuna dhe sipas radhitjes në tërë territorin e Komunës së Prishtinës, brenda orarit të punës në objektin përkatës.

Neni 8

Shërbimet që do të ofrohen

Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj kontrate janë shërbimet primare dhe sekondare sipas standardeve të detajuara të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A.

Neni 9

Forca madhore

1. Nga "Pastrimi" nuk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në shtojcën A nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë forcë madhore.
2. Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton që përmbushja e detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose jopraktike sa që në mënyrë të arsyeshme të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ku përfshihet por jo kufizuar, lufta, protestat, tërmeti, zjarri, shpërthime, stuhi, përmbytje, epidemi, apo çdo situatë e ngjajshme e cila përcaktohet me ligj apo ndonjë formë tjetër nga ana e organeve kompetente shtetërore.
3. Forca Madhore nuk përfshin një ngjarje, e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njëres palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj, një ngjarje të cilën, një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme duhet ta kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë;
4. Forca Madhore nuk përfshin panjaftueshmërinë e fondeve për të operuar ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

Neni 10

Mbledhja, transportimi dhe deponimi i mbeturinave

1. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave ofrohen në përputhje me specifikacionet e hollësishme të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A dhe që janë përmbledhur si vijon:
 - 1.1. "Pastrimi" siguron që të ofrohet numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbledhjen e mbeturinave nga subjektet e shërbyera dhe që vëllimi dhe

specifikacionet e tyre të mjaftojnë për ta vendosur në to sasinë e mbeturinave të amvisërisë të prodhuara. Numri dhe lloji i kontejnerëve duhet të llogaritet duke e përdorur një shkallë mesatare të prodhimit të mbeturinave dhe duke u bazuar në përvojën e mëparshme.

- 1.2. "Pastrimi" ofron shërbim të mbledhjes së mbeturinave të rregullt, duke u siguruar që të janë vendosur në kontejnerë gjitha mbeturinat komunale (apo që janë derdhur përreth tyre) të mbledhen dhe transportohen në vendet e caktuara.
- 1.3. Ky shërbim do të ofrohet duke u bazuar në Planin e Itinerarit dhe Operativ (PIO-në) për çdo zonë të shërbimit. Në ditët pas festave publike mund të kërkohen shërbime shtesë.

2. Sipas efikasitetit të punës, "Pastrimi" e përgatitë dhe dorëzon një PIO dhe në të përfshinë:

- 2.1. Sistemin e itinerarit: Bazuar në lokacionet e kontejnerëve (posaçërisht të kontejnerëve të komunitetit), siç është përcaktuar nga Komuna, në secilin vendbanim brenda zonës së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave, "Pastrimi" duhet ta krijojë një sistem të itinerarit të cilin do ta ndjekin automjetet për mbledhjen e mbeturinave dhe t'i dorëzojë atë Komunës për aprovim.
- 2.2. Xhirot e rregullta të mbledhjes dhe orari i tyre: Orari i shërbimeve duhet të bazohet në llogaritjet, specifikacionet e secilit vendbanim dhe përvojën e mëparshme të "Pastrimi"-të. Llogaritjet për secilin vendbanim duhet të bazohen në numrin e banorëve, llojet e mbeturinave të prodhuara dhe shkallët e prodhimit të mbeturinave.
- 2.3. Intervalet e rishikimit: PIO-ja do të rishikohet duke u bazuar në një mekanizëm drejtues në intervale periodike prej 3 muajsh apo kur të kërkohet nga Komuna.

3. Në zonat ku ka qasje të kufizuar të automjeteve, "Pastrimi" mund të sigurojë kontejnerë të komunitetit në periferi të vendbanimit apo t'i mbledhë dhe largojë mbeturinat duke përdorur automjete të vogla me specifikacione të përshtatshme teknike. "Pastrimi" i ofron shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave me anë të automjeteve/pajisjeve teknologjike në dispozicion, të përshtatshme për lëvizje në këtë zonë dhe të pajisura me një pajisje funksionale për ngritje mekanike.

Neni 11

Mbulimi me shërbime

1. Vendbanimet: "Pastrimi" është përgjegjëse sipas kësaj Kontrate që të ofrojë shërbime të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave nga të gjitha vendbanimet brenda hapësirës së shërbimit, siç është përkufizuar në këtë kontratë. "Pastrimi" është përgjegjëse për pastërtinë në tërë territorin e Komunës së Prishtinës, duke përfshirë heqjen e të gjitha mbeturinave të parrezikshme në tërë territorin e Komunës së Prishtinës.
2. Për secilin vendbanim, "Pastrimi" do të ofrojë shërbim të duhur të mbledhjes së mbeturinave ose duke u bazuar në kushtet lokale, ose siç është përkufizuar në PIO, duke përdorur kontejnerë të përbashkët apo përmes shërbimit derë më derë.

3. Shërbimi për institucionet publike do të ofrohen varësisht nga lloji i institucionit, lloji i mbeturinës së prodhuar, sasi të mbeturinave të prodhuara dhe vendndodhja në raport me subjektet e tjera të shërbyera.

Neni 12

Resurset dhe shkathtësitë

1. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të ofrohen nga një ekip i trajnuar në mënyrë adekuate dhe profesionale që i posedon shkathtësitë relevante për ta ndërmarrë shërbimin.
2. Në të gjitha objektet dhe vendet e caktuara për menaxhimin e mbeturinave punësohen anëtarë të trajnuar të personelit, të specializuar në detyrat përkatëse të tyre.
3. Ekipi i menaxhimit të kompanisë "Pastrimi" ndërlidhet dhe bashkërendohet me Komunën dhe është i hapur për inspektim nga përfaqësuesit apo zyrtarët kompetent të Komunës.
